



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1924/1 Prot

Tiranë, më 14/12 / 2016

Lënda: *Jepet mendim për projekt udhëzim.*

Drejtuar: **Z. Saimir TAHIRI**  
**MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME**

Tiranë

I nderuar Z. Tahiri,

Me shkresën nr. 5864 prot, datë 07.12.2016, keni dërguar për mendim p/udhëzimin “*Mbi procedurat për përpunimin, evidentimin, identifikimin dhe transmetimin e të dhënave (gjurmët e gishtave) të gjetura në vendin e ngjarjes, për vepra kriminale, në sistemin Aftis Civil të përmirësuar të kompanisë Aleat*”.

Ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nëpërmjet nenit 5, 6 dhe 7 të tij, parashikon për kontrolluesit që përpunojnë të dhëna personale, zbatimin e disa parimeve të rëndësishme për të realizuar një përpunim të drejtë dhe të ligjshëm.

Zbatimi i tyre është parashikuar në pikën 1 dhe 2 të projekt udhëzimit me përcaktimin e mbështetjes ligjore, qëllimit të përpunimit dhe institucioneve që kjo e drejtë u njihet me Kodin e Procedurës Penale.

Gjithashtu, subjektet e parashikuara në pikën 11 të projekt udhëzimit, në cilësinë e kontrolluesit, duhet të kryejnë përpunimin e të dhënave, në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Për këtë qëllim, përpara nisjes së përpunimit të të dhënave nga kontrolluesit, duhet zbatuar detyrimi i nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, me përditësimin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit.

Në vijim kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të ligjit, duhet të administrojë/miratojë rregulla të posaçme për këtë përpunim duke parashikuar masa të përshtatshme mbrojtjeje. Në këtë kontekst, kontrolluesi duhet të mbajë në vëmendje se niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

